

SEANCA E KE E LSHMP-së

# NJË LIGJ TË VEÇANTË PËR ORGANIZIM PENSIONAL

Për përpilimin e Propozim-ligjit në LSHMP u formua një grup pune i përbërë nga persona me profesionalitet dhe përvojë të dëshmuar për këtë problematikë



Më 27 nëntor u mbajt seanca e Këshillit Ekzekutiv të LSHMP në të cilën pika kryesore e rendit ditor ishte miratimi i versionit përfundimtar të Propozim - Ligjit për organizim pensional në Maqedoni. Në seancën krahas anëtarëve të KE morrën pjesë edhe Besnik Pocesta kryetari i Parlamentit të LSHMP dhe kryetari i Forumit ekonomik-juridik dr. Fidanço Stoev.

Në fillim të seancës kryetari Dragi Argirovski theksoi: "Rëndësia e sjelljes së një ligji si ky për rreth 320 000 pensionistë është e madhe. Pensionistët si asociacioni më i madh në Republikë e Maqedonisë e meritojnë atë. Një ligj si ky do të sigurojë zgjedhjen e shumë çështjeve në lidhje me popullatën pensioniste dhe do t'i mbron të drejtat e tyre në një nivel më të lartë e cila u është siguruar

me Ligjin ekzistues për shoqatat dhe fondacionet".

Pastaj doli Stanka Trajkova, sekretare e KE të LSHMP dhe kryetar i komisionit përgjegjëse për përpilimin e Propozim - Ligjit ku mbi të gjitha tha: "Duke u nisur nga fakti që zhvillimi i sektorit civil ka rëndësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e demokracisë në RM, është sjellë Ligji për shoqatat dhe fondacionet me të cilin sigurohet ndërtimi i shoqërisë demokratike, me pjesëmarrje të qytetarëve në rrjedhat e përgjithshme sociale. Megjithatë, nëse Ligji ekzistues për shoqatat dhe fondacionet ashtu si kuadër i përgjithshëm ligjor krahasohet me nevojat e popullatës pensioniste prej rreth 320.000 shfrytëzues të pensionit, do të shihet që në këtë fushë lidhur

me pensionistët ekzistojnë shumë dallime specifike nga sferat dhe subjektet tjera shoqërore".

Për atë shkak, sjellja e Ligjit për organizim pensional si ligj i veçantë imponohet si imperativ për zgjedhjen e çështjeve të cilat janë me rëndësi për pensionistët.

Ky ligj i veçantë do të zgjidhte çështje të shumta nga karakteri organizativ dhe thelbësor.

Qëllimi kryesor i Propozimligjit është të avancohet dhe sigurohet organizim më kualitativ të shfrytëzuesve të pensionit në shoqatat dhe lidhjet, ndërsa parimet themelore mbi të cilat bazohet janë: parim territorial, veprimtari jo partiak, publicitet dhe transparencë, jo varshmëri në realizimin e qëllimeve dhe mbrojtje të drejtave dhe interesave të shfrytëzuesve të pen-

sionit në pajtim me Kushtetutën, si dhe lidhshmëri horizontale dhe vertikale mes shoqatave të Lidhjes. Për këtë qëllim LSHMP para disa viteve nisi një iniciativë për sjelljen e ligjit të veçantë për organizim pensional në Maqedoni. Për përpilimin e Propozim-ligjit në LSHMP u formua një grup pune i përbërë nga persona me profesionalitet dhe përvojë të dëshmuar për këtë problematikë. Pas miratimit të tekstit nga Forumi juridik-ekonomik i KE të LSHMP ishte i dorëzuar për debat publik në të gjitha katër Lidhjet, gjegjësisht në të gjitha shoqatat anëtare të lidhjeve që të japin mendimet e tyre, plotësime dhe korrigjime të mundshme.

Pjesa më e madhe e anëtarësisë dha kontribut për përpilimin e versionit përfundimtar, por vetëm një numër i vogël nga shoqatat nuk dhanë mbështetje për sjelljen e këtij ligji, duke mos dashur ose mos mundur ta perceptojnë dobënë e sjelljes së tij.

Pas debatit versioni përfundimtar i Propozim - ligjit u pranua dhe u vendos që i njëjti të parashtrahet deri tek Ministria e punës dhe politikës sociale për procedurë të mëtejshme.

(Kalina S. Andonova)

IN MEMORIAM



## Ndërroi jetë kryetari i pensionistëve të Pogradecit, Naziv Dajlani

Pas një sëmundje të gjatë dhe të rëndë në moshën 79 vjeçare, ndërroi jetë kryetari i Konfederatës së sindikatave të pensionistëve të qytetit të Pogradecit, Shqipëri, Naziv Dajlani. Të gjitha vitet e tij të punës i kaloi në organizatat shoqërore politike të Pogradecit, ndërsa pas pensionimit rreth njëzet vjet ishte kryetar i Organizatës së pensionistëve të Pogradecit.

Falë angazhimit të tij dhe dëshirës së tij për vendosje të bashkëjetesës vëllazërore në bazë multietnike, ai ishte edhe kryetari i parë me të cilin SHP Ohër dhe Debërcë vendosi bashkëpunim ndërkombëtar. Marrëdhëniet miqësore me SHP Ohër dhe Debërcë me pensionistët e Pogradecit ishin të formalizuara me nënshkrimin e Marrëveshjes për bashkëpunim, saktësisht para dhjet viteve në Ohër. Dajlani ishte anëtar nderi i Shoqatës së pensionistëve të Ohër, ndërsa me respekt ishte i nderuar edhe nga SHP Strugë, SHP Dibër dhe Qendra Zhupë dhe shoqatat tjera. Konfederata e sindikatave të pensionistëve të qytetit të Pogradecit, Shqipëri kishte bashkëpunim të frytshëm edhe me LSHPM. Për angazhimin e vet të pasur shoqëror politik, Dajlani është shpërblyer me shumë mirënjohje komunale dhe republikane në qytetin e lindjes Pogradecin. Për bashkëpunimin e suksesshëm ndërkombëtar dhe për fqinjësi të mirë me SHP Ohër dhe Debërcë dhe LSHPM, Dajlani ka marrë plaketë dhe mirënjohje.

## SHP TETOVË

### Një shtëpi e domosdoshme për pleqtë

Në rajonin e Pollogut të Poshtëm, i cili krahas qytetit të Tetovës, përfshin edhe pesë komuna rurale (Bogovinë, Brvenicë, Zhelelinë, Jegunovce dhe Tearcë), nuk ekziston shtëpi të pleqve.

Sipas numrave me të cilat disponojmë, në këtë rajon ka rreth 16.000 pleq dhe pensionistë me aftësi të kufizuara, ndërsa edhe disa mijëra udhëhiqen si të moshuar, ose total rreth 25.000. Shumica prej tyre, shpesh ballafaqohen me çështjen për hapësirë banimi të përshtatshme ose akomodim, e cila si situatë zbutet përmes akomodimit në shtëpi të pleqve në qytete tjera të vendit.

Duke marrë parasysh këtë gjendje, Shoqata e pensionistëve Tetovë para më shumë se pesë viteve e ngriti çështjen për ndërtim të shtëpisë së pleqve me kushtet për akomodim ditor ose qëndrim ditor. Problemi është aktualizuar në të gjitha gjashtë komunat dhe në Qendrën për zhvillim ekonomik të Pollogut të Poshtëm.

Përveç informimit të mëparshëm, SHP Tetovë u drejtua edhe me kërkesë shtesë për ndërmarrjen e aktiviteteve të nevojshme për ndërtimin e shtëpisë së pleqve. Për këtë nevojë, është kontaktuar edhe me disa organizata joqeveritare të cilat e përcjellin çështjen për gjendjet aktuale me personat e moshuar. Në këtë problem SHP Tetovë referohet edhe në raportin për punë në vitin e fundit. Edhe krahas të gjitha angazhimeve dhe aktualizimit të nevojës, deri më sot nuk ka asnjë masë konkrete. Problemi ende po qëndron dhe askush nuk përf-

shihet me të që ta zgjedhë. Sidoqoftë, çështja për ndërtimin e shtëpisë për pleq në rajonin e Pollogut të poshtëm mbetet e hapur. Interesimi i pensionistëve edhe kategorive të tjera të rritura të qytetarëve po rritet. Mbetet të realizohet angazhim konkret prej një nga institucionet kompetente, të bashkohen interesi dhe mjetet dhe të ndërmerren hapa konkrete me të cilat do të ju sigurohej pleqve dhe pensionistëve që t'i kalojnë pa shqetësim vitet e mbetura të gjeneratës së tretë. (G. .)

## SHP KUMANOVË

### Kumanova, qyteti evropian i sportit për vitin 2019

Komisioni për vlerësim të ACES Evropa nga Brukseli, më 20 nëntor 2018, qëndroi në Kumanovë për të realizuar mbikëqyrje në situatën aktuale dhe ta njoftojë vendimin e Asociacionit evropian të qyteteve të sportit, që Kumanova është fituesi i titullit "Qyteti i sportit në vitin 2019". Në kuadër të vizitës, përfaqësuesit e Asociacionit të qyteteve të sportit në Evropë, ishin në disa objekte sportive në të cilat përfaqësuesit ishin të njoftuar në vend ndodhje për kushtet për sport dhe rekreacion në Kuma-

novë.

Në objektin e njohur "Sokolana", i ndërtuar para rreth njëqind viteve dhe i paraparë kryesisht për sport dhe rekreacion të qytetarëve të ri të Kumanovës, mes sportistëve aktiv u gjenden edhe pensionistët e SHP Kumanovë, të udhëhequr nga profesoresha e edukatës fizike, Ljubica Kuzmanovska, e cila punon në popullarizimin dhe promovimin e sportit në shoqatën. Në këtë rast, rreth 80 pensionistë sportist treguan që njerëzit në Kumanovë vazhdojnë t'i zhvillojnë

aktivitetet sportive edhe në ditët pas pensionimit, përmes ushtrimeve dhe trajnimeve në terrenet kryesisht në dhe rreth "Sokolana".

Për aktivitetet sportive të pensionistëve kumanovarë, përfaqësuesit evropian i informoi sekretari i SHP Kumanovë, Jasmina Todorovska, e cila në këtë rast foli për sukseset sportive të garave Republikane sportive 2018 të pensionistëve të cilat u mbajtën në Radovish. John Swanson, kryetari i Asociacionit të qyteteve të sportit në Evropë u befasua këndshëm



nga ajo që dëgjoi dhe pa dhe i përgëzoi pensionistët për sakrificimin, angazhimin dhe këmbënguljen e tyre në përkujdesjen e shpirtit sportiv edhe në moshë më të moshuar. Kur u largua, ai u dëshiroi jetë të gjatë dhe të jenë krenar për njohjen që qyteti i tyre është shpallur për qytet të sportit në

Evropë për vitin 2019, të vazhdojnë të merren me sport dhe rekreacion, të jetojnë një jetë të shëndetshme, por edhe t'i motivojnë të rinjtë që ta ndjekin shembullin e tyre. Si kujtim, në fund u realizua një fotografi e përbashkët me të gjithë të pranishmit në sallën në "Sokolana". (J.T)